

## **Udhëkryqet përpara nesh Neoimperializmi apo Uniteti Evropian**

**Article by Rui Tavares**

April 14, 2022

**Që kur Rusia sulmoi Ukrainën të enjten më 24 shkurt, një valë solidariteti me rezistencën Ukrainase ka përfshirë Evropën. Uniteti i paprecedentë pasqyron se si lufta nuk ka të bëjë vetëm me Ukrainën, por me të ardhmen e të gjithë Evropës. A do ta mbizotërojë neoimperializmi në shekullin 21 apo do të lindë një Evropë e lirë, demokratike dhe e bashkuar?**

Gjatë dekadave të fundit, propaganda e Vladimir Putin ka pasur një efekt të konsiderueshëm në politikën evropiane dhe më gjerë. Kjo është një propagandë oportuniste, e lidhur kryesisht me sigurimin e fitoreve taktike dhe demoralizimin e konkurrentëve të tij. Si rezultat, sektorë të ndryshëm ideologjikë janë rreshtuar me propagandën e Putinit për arsye të ndryshme. Disa menduan se anti-imperializmi amerikan ishte i mjaftueshëm që ata të bëheshin aleatë objektivë të imperializmit rus, ndërkohë që vazhdonin ta quanin veten “anti-imperialistë”. Të tjerët, në skajin e kundërt të spektrit ideologjik, e panë Putinin si kalorësin e bardhë të nacionalizmit dhe të ndjenjave reaksionare globale, duke mbrojtur vlerat tradicionale kundër kozmopolitizmit bashkëkohor dhe lirive individuale. Në qendër, aderimi ideologjik nuk ishte i nevojshëm për të bindur shumë politikanë për pragmatizmin e interesit ekonomik, në shumë raste personale – pse të shqetesohen për t’i bindur politikanët dhe sundimtarët me argumente kur në shumë raste mjafton t’i manipulosh? Pavarësisht se kishte mesazhe të ndryshme për çdo grup interesi, duke kultivuar kështu aleatë në familje të ndryshme politike, madje edhe kundërshtarë, gjithmonë kishte diçka pas propagandës së Putinit që mund të përshkruhet si një ideologji kohezive, e unifikuar me qëllime të qarta.

Elementet thelbësore të kësaj ideologjie janë si më poshtë: njerëzit e thjeshtë, qofshin ata rusë ose nga vende të tjera, nuk janë mjaft të afte për të qeverisur veten dhe janë më mirë të jetojnë nën autoritetin e një njeriu të fortë. Në nivel botëror, vendet nuk janë të gjitha të barabarta, dhe disa duhet të jetojnë nën tutelën e të tjerëve, sipas fatit gjeografik ose historik. Të fortët e vendeve të forta nuk kanë nevojë t’ua përcjellin botëkuptimin e tyre nënshtetasve, të cilët nuk do ta kuptonin gjithsesi – propaganda është e mjaftueshme. Në frontin e brendshëm, motoja e vjetër autokrasi-ortodoksi-nacionalitet, nga ministri i Nikolla I, Sergej Uvarov (1786-1855), mbetet i mjaftueshëm për të përshkruar thelbin e politikës së Putinit. Por nëse e veçojmë substancën nga forma e mesazhit të Putinit, nuk është e vështirë të përkufizohet ideologjia e tij: është një neoimperializëm reaksionar, që duket pothuajse tipik i shekullit të 19-të ose gjysmës së parë të shekullit të 20-të, por i përshtatur me teknologjinë dhe realitetet komunikuese të shekullit 21-të.

Duhet të jemi të qartë për pasojat e një fitoreje të mundshme të neoimperializmit në kohën tonë. Nëse Putini arrin të aneksojë Ukrainën, superfuqitë e tjera, herët a vonë, do t’i

përshtaten realitetit të ri. Secili do të kishte sferën e tij të influencës dhe çdo “punë e papërfunduar” do të trajtohej drejtpërdrejt midis të fortëve të tyre. Në një botë të tillë, realitetet si Bashkimi Evropian (të cilin Trump në mënyrë eksplicite e shpalli si “armik” të pikëpamjes së tij për botën dhe interesat e SHBA-së) do të duhej të dobësohej dhe të ndahej, sepse vetëm nëpërmjet tyre kombet e mesme dhe të vogla, nëpërmjet ndarjes vullnetare të sovranitetit, mund të forcojnë sovranitetin dhe pavarësinë e tyre në botën globale. Kjo nuk është një botë në të cilën qytetarët e vendeve të vogla dhe të mesme në Evropë do të kishin fjalën ose do të dëshironin të jetonin.

## **Our latest edition - Moving Targets: Geopolitics in a Warming World - is out now.**

It is available to read online & order straight to your door.

[READ & Order](#)

Por ka një kundërvënie ndaj këtij botëkuptimi.

Në kompleksitetin e tyre të jashtëzakonshëm, këto momente të historisë kanë virtytin e paraqitjes së tyre si një udhëkryq i qartë. Zgjedhja themelore me të cilën përballemi është kjo: neoimperializëm apo unitet Evropian? Nuk ka opsione të ndërmjetme. Nëse neoimperializmi fiton, Evropa nuk do të ketë autonomi strategjike për të përcaktuar të ardhmen e saj – përballë një Putini si me një Xi Jinping apo ndonjë Trump të ri në Shtëpinë e Bardhë. Por një Evropë e bashkuar do të ishte në vetvete një humbje për neoimperializmin.

Një Evropë që është në gjendje të kujdeset për fatin e saj kolektiv do të duhet të bëjë të gjitha bisedat që ka shtyrë për dekada me radhë, duke fillur me aftësinë e saj për të rikonvertuar ekonominë e saj duke i dhënë fund varësisë së saj nga karburantet fosile, për të koordinuar politikën e saj të mbrojtjes ose të thellojë integrimin e saj për t’u përgatitur për një zgjerim të mëtejshëm të mundshëm. Meqenëse nuk mund ta mbrojë me besueshmëri demokracinë pa qenë vetë një demokraci e plotë, Evropa do të duhet të jetë një bashkim politik demokratik, nëse do të jetë një bashkim. Për këtë, të gjitha shtetet e saj anëtare do të duhet të jenë shtete të sunduara nga ligji, sepse, siç ka treguar shembulli i Viktor Orbánit, praktikantët e tiranëve janë gjithmonë të gatshëm të zgjidhen nga zotërinjtë e tyre kudo në botë. Dhe duhet të jetë një Evropë që është një bashkim i të drejtave themelore, ato të secilit prej qindra miliona qytetarëve të saj, pavarësisht se në cilin shtet anëtar ndodhen.

Një Evropë e tillë do të jetë në gjendje të sjellë prosperitet të përbashkët për të gjithë njerëzit e saj – në vend të masave shtrënguese të memorandumëve të “trojkës” që iu imponuan disa anëtarëve gjatë dekadës së fundit – dhe përgjegjësi ekologjike për planetin në tërësi. Do të jetë një shembull për qytetarët e vendeve të vogla dhe të mesme anembanë botës dhe do të qëndrojë si një bastion ekonomik, social, kulturor dhe politik kundër neoimperializmit reaksionar, autoritar dhe luftënxitës, ngado që ai vjen. Një Evropë e tillë do të jetë, mbi të gjitha, një Evropë për të cilën ia vlen të luftohet, së cilës shumë do të duan t’i bashkohen dhe që gjithmonë do të respektojë zgjedhjet që secili vend zgjedh të bëjë nëse do të qëndrojë apo jo në të. Sepse, me gjithë diversitetin e saj historik dhe kulturor, një Evropë e bashkuar dhe e lirë mund të jetë vetëm armiku i neoimperializmit. Kushdo që është antiimperialist duhet ta kundërshtojë strategjinë e Putinit dhe t’i

kundërvihet asaj me një strategji tjetër, më të mirë: një strategji më çliruese, më respektuese për identitetet e shumta nga të cilat jemi krijuar, më produktive për të ardhmen dhe për rrjedhojë më e aftë për të mobilizuar milionat e saj me një vizion pozitiv të denjë për shekullin e 21-të.

Neo Imperializmi na ka treguar tashmë se ku të drejton: në luftë, vuajtje dhe vdekje. Le të jemi të aftë ta mbushim projektin e unitetit Evropian me shpresë dhe jetë.

---



Rui Tavares is a Portuguese writer, historian, and member of the parliament for the left-green-libertarian party LIVRE. He is the author of the documentary film *Ulysses: Breaking the Spell of the Crisis to Save Europe*. He was formerly an MEP for Greens/EFA.

Published April 14, 2022

Article in Albanian

Translation available in English

Published in the *Green European Journal*

Downloaded from <https://www.greeneuropeanjournal.eu/udhekryqet-perpara-nesh-neoimperializmi-apo-uniteti-evropian/>

*The Green European Journal offers analysis on current affairs, political ecology and the struggle for an alternative Europe. In print and online, the journal works to create an inclusive, multilingual and independent media space.*

*Sign up to the newsletter to receive our monthly Editor's Picks.*